

MENDIM PARALEL

Unë, Genta Tafa (Bungo), anëtare e trupit gjykues që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Suela Beluli, duke rënë dakord me vendimmarrjen përfundimtare në kushtet që ndodhen aktet, mendoj se hetimi dhe, për pasojë, vlerësimi i disa fakteve duhet të ishte bërë ndryshe, duke qenë më shterues. Duke mos qenë dakord mbi një pjesë të qëndrimit të mbajtur nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, që ka çuar në disa konkluzione që nuk më gjejnë dakord, në vijim, po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit.

1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar pasurinë njësi me sipërfaqe 36.7 m² në qytetin e Elbasanit, me vlerë 1,900,000 lekë. Në lidhje me fitimin e pronësisë së kësaj pasurie subjekti ka deklaruar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.12.2007. Si burim për këtë pasuri subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në vitin 2005 në “Raiffeisen Bank”, si dhe të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit të saj.

2. Referuar kontratës së shitjes të depozituar nga subjekti në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, në cilësinë e shitësit rezultojnë shtetasit Z.A.T dhe M.T, të cilët janë përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi O.T.

Në kontratë përcaktohet se: *“Blerësja Suela Beluli është dakord me shumën e vendosur midis tyre dhe deklaron se ka bërë shlyerjen e shumës 1,900,000 lekë, sot, jashtë kësaj zyre noteriale”*.

3. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën 2,017,827 lekë.

4. Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka depozituar në cilësinë e provës:

- kontratë datë 30.9.2005, me sipërmarrës shtetasit Z.A.T dhe M.T;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.1.2023, të shtetasit M.T, i datëlindjes 14.3.1937.

5. Kjo kontratë jonoteriale është depozituar nga subjekti për herë të parë vetëm pas kalimit të barrës së provës. Duke qenë se ajo ka shërbyer si dokument që tregon për origjinën e pronës, subjekti ka pasur detyrimin ta depozitonte së bashku me deklaratën *Vetting* ose të paktën gjatë hetimit administrativ. Fakti që kjo kontratë e lidhur ndërmjet palëve, jo në prezencë të noterit, del në skenë për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, mendoj se duhet të ishte objekt hetimi. Në këndvështrimin tim, hetimi duhet të përqendrohej në vërtetësinë e kësaj kontrate, si dhe në vërtetësinë e pasojave që ka sjellë.

6. Në lidhje me dy aktet e mësipërme kam kërkuar që të riçelej hetimi duke u administruar dosja e plotë e pronës, në të cilën është ndërtuar objekti ku ndodhet njësia, me qëllim që të provohej që kontrata e sipërmarrjes ka qenë reale. Unë mendoj se jo pa qëllim kjo kontratë nuk ka një emërtim për llojin e saj, por palët janë emërtuar si sipërmarrës dhe porositës, për pasojë efektet e saj janë ato të një kontrate sipërmarrjeje. Për aq sa është hetuar, dy shtetasit që paraqiten në kontratë si sipërmarrës, në fakt rezultojnë pronarë të truallit, mbi të cilin po ndërtohej dhe jo investitorë në ndërtim. Gjithashtu hetimi ishte i nevojshëm për t’u provuar që në momentin e lidhjes së kontratës

me subjektin, bashkëpronarët kishin lidhur kontratën e sipërmarrjes me firmën e ndërtimit, ku të përcaktohej qartë dhe pjesa e tyre takuese, për të provuar mundësinë e tyre për të shitur një pasuri në të ardhme.

7. Bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹ në lidhje me deklaratën noteriale, vlerësoj se megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo nuk ka fuqi provuese në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështetet nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në këtë proces. Për këtë arsye, duke marrë në konsideratë edhe moshën e deklaruesit në momentin e deklarimit, 86 vjeç, kam kërkuar që ai të thirret në cilësinë e dëshmitarit, me qëllim verifikimin e plotë të aftësisë së tij për të kuptuar dhe mbajtur mend në janar 2023 se çfarë ka ndodhur ekzaktësisht në datën 17.1.2006, si dhe të deklarimeve të tij në këtë deklaratë.

8. Ky qëndrim i imi në lidhje me zgjerimin e hetimit mbështetet edhe në faktin se:

- i. Subjekti nuk rezulton të ketë depozituar deklaratë noteriale të shitësit tjetër.
- ii. Kontrata e sipërmarrjes duket se nuk është në përputhje me kontratën e shitblerjes, pasi:
 - në kontratën e shitblerjes vetë subjekti ka deklaruar se ka paguar shumën 1,900,000 lekë në datën e lidhjes së kontratës, ndërkohë në kontratën e sipërmarrjes përcaktohet një modalitet tjetër pagesash, i cili përputhet në mënyrë të plotë me veprimet bankare të subjektit duke e bërë të dyshimtë këtë kontratë;
 - kontrata e shitblerjes nuk është nënshkruar nga bashkëpronarët, ku përfshihet edhe shtetasi M.T, por nga përfaqësuesi me prokurë i tyre (duke u ngritur dyshime mbi deklaratimet e shtetasit M.T në deklaratën noteriale), ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes duket se ka nënshkrimin e bashkëpronarëve.

9. Për sa i përket analizës financiare për këtë pasuri kam kërkuar një hetim në lidhje me kreditë e marra nga F.B, të cilat në deklaratën *Vetting* nuk janë deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të ishin përfshirë në analizë financiare.

10. Nga ana e subjektit, gjatë periudhës që janë marrë kreditë (si dhe në një periudhë më të hershme) përfshirë edhe kredia në “Raiffeisen Bank”, janë kryer transaksione financiare bankare², për të cilat gjatë procesit të rivlerësimit subjekti është pyetur duke deklaruar për disa prej tyre si burim të ardhurash të familjarëve të saj, ndërkohë që ato duhet të shiheshin në prizmin e shpenzimeve të subjektit lidhur me kreditë e marra³.

¹ Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; dhe vendim nr. 11/2021 (JR), datë 31.3.2021.

² Shihni pyetësin e datës 16.11.2022, si dhe pyetësin standard.

³ Shihni pyetësit datë 7.11.2022 dhe datë 16.11.2022, si dhe pyetësin standard.

11. Subjekti, pasi ka tërhequr nga llogaritë bankare shuma të konsiderueshme, është larguar për në Kanada, duke u krijuar dyshimi që këto shuma mund të jenë shpenzuar në këtë shtet për nevojat e subjektit, por ky fakt mund të provohet vetëm me një hetim më të thelluar.

12. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e shumës 1,250,000 lekë të depozituar në datën 24.11.2005 në llogarinë bankare të saj në “Alpha Bank”, pasi në pyetësinë e datës 16.11.2022 ka deklaruar se: *“Shuma prej 1,250,000 lekësh, e depozituar cash në datën 24.11.2005, ka burim kontratën e kredisë pranë ‘Raiffeisen Bank’, datë 18.8.2005”*.

Ndërkohë, në parashtrimet, pas kalimit të barrës së provës, ka deklaruar se kjo shumë ka pasur si burim një pjesë nga kredia dhe një pjesë nga të ardhurat nga paga.

13. Gjatë hetimit është konstatuar edhe një kontratë porosie e lidhur në datën 12.5.2008, sipas së cilës rezultonte se subjekti kishte paguar shumën 20,000 euro.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti, sërish, për të provuar pretendimet e saj, ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.1.2023, sipas së cilës z. V.K deklaroi se subjekti nuk ka paguar shumën 20,000 euro.

Në kushtet kur deklarata noteriale merret me rezervë, ka qenë e nevojshme kryerja e një hetimi më të thelluar në lidhje edhe me këtë marrëdhënie të subjektit.

14. Në përfundim, në lidhje me kriterin e pasurisë konstatohet se subjekti, për të kthyer barrën e provës, ka depozituar një dokumentacion për të cilin ishte e nevojshme kryerja e një hetimi më të thelluar, pasi duket se ai është përgatitur me qëllim arrijen e një rezultati pozitiv për procesin e rivlerësimit të subjektit. Duke qenë se dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues nuk pranuan çeljen e hetimit, në kushtet në të cilat ndodhen aktet, pavarësisht dyshimeve të arsyeshme, kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit.

15. Vlerësoj të ndalem në lidhje me faktin e krijimit të pasurive përpara fillimit të detyrës.

Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁴, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi kalimtar *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, arrihet në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në

⁴ Vendimet nr. 15/2019, nr. 8/2019, nr. 19/2019 dhe nr. 13/2020.

dyschim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

16. Në lidhje me kriterin e figurës kam konstatuar se subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar një dokument që nuk është në formën e një kontrate të nënshkruar nga z. A.M dhe z. A.B, sipas të cilit pranohej shërbimi i ofruar nga z. M për gjetjen e një apartamenti.

Ky dokument, që nuk është depozituar nga subjekti gjatë hetimit, duket se është përgatitur me qëllim arritjen e një rezultati favorizues për procesin e rivlerësimit të subjektit. Në lidhje me këtë dokument dhe me të gjitha konstatimet për sa i përket kriterit të figurës, vlerësoj se ato në mënyrë autonome nuk mund të shërbejnë për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimi.

Në përfundim, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, nëse nga Komisioni do të vijojë hetimi, mund të rezultonin të dhëna, të cilat nuk përputhen me provat e administruara, të cilat, parë së bashku me konstatimet e tjera për sa i përket kriterit të figurës, që lidhen me marrëdhënien e subjektit me z. K, mund të çonin në një vlerësim tërësor të saj. Komisioni, në marrjen e vendimit në lidhje me subjektin e rivlerësimit, është bazuar vetëm në dokumentacion në nivel deklarativ, për të cilin ishte i nevojshëm një hetim më i thelluar. Personalisht mendoj se deklaratat noteriale, të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, nuk mund të provojnë marrëdhënie të krijuara para shumë vitesh. Ky qëndrim i imi vjen në vijim të qëndrimit të mbajtur edhe në rastin N, si dhe bazohet në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵.

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

⁵ Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; dhe vendim nr. 11/2021 (JR), datë 31.3.2021.